

VËZHGIMI I PROTOKOLLEVE FARMAKOLOGJIKE NË TRAJTIMIN E METRITEVE TE LOPËT PËR QUMËSHT

THE MONITORING PROTOCOLS IN THE PHARMACOLOGICAL TREATMENT OF METRITIS TO COW'S MILK

FEJZO SELAMI*, VASILIKA DINI, BEJO BIZHGA, KASTRIOT KORRO, LUIGJ TURMALAJ, ARBEN POÇARI

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti Bujqësor i Tiranës

PËRMBLEDHJE

Studimi u krye te lopët e fermës "Derveni" për një periudhë 1-vjeçare (2008). Krerët e marra në studim u vëzhguan për infeksione vaginale dhe uterine, dy javë para pjelljes deri gjashtë javë pas pjelljes. Rezultuan me endometrite dhe metrite 20 krerë, që përfaqësonin 13,8 % të totalit të kafshëve të kontrolluara. Këto lopë u ndanë në dy grupe. Grupi u parë u trajtua vetëm me antibiotik Exenel, (Exenel flacon 100 ml, Crawley, RH 102LZ,UK) me dozën 1 ml/10 kg peshë. Grupi i dytë u trajtua me skemë të kombinuar: antibiotik plus substanca hormonale, konkretisht: Oxitocin 4 ml i.m.(Oxytocine-10, flacon 50 ml, Interchemia, Holland), Exenel 1ml/10 kg peshë i/m për 5 ditë rresht, si dhe me Prosvolen 10 ml, Alfassan, Holland) (Pg F2 alfa) 2ml i/m. Efektiviteti i skemës terapeutike në grupin e parë rezultoi 60% dhe dha 3 recidiva. Efektiviteti i skemës terapeutike në grupin e dytë rezultoi 90% dhe dha 1 recidivë. Ky rezultat tregon efektet përforcuese të prostoglandinës në involucionin uterin, evakuimin e produkteve inflamative, stimulimin e ciklit të ardhshëm, stimulimin e imunitetit lokal uterin dhe përmirësimin e tkurrjeve uterine. Pra, protokollet më efikase për trajtimin e endometriteve dhe metriteve te lopët e qumështit janë kombinimet e terapisë antibiotike me atë hormonale, të cilat përmirësojnë parametrat e riprodhimit, si: kohën e ndërzimit të parë, indeksin e ndërzimit dhe përmirësimin e fertilitetit.

Fjalë çelës: lopë qumështi, metrite, PgF2alfa, Exenel

ABSTRACT

The study was conducted to cow's farm "Derveni" for a 1-year period (2008). The cows in the study were monitored for uterine and vaginal infections, two

weeks before they were born until six weeks after it. 20 cows resulted with metritis and endometritis, representing 13.8% of the total animal controlled. These cows were divided into two groups. The first group was treated only with antibiotic Exenel with a dose of 1 ml/10 kg weight. The second group was treated with a combined scheme: antibiotic and hormones substances: Oxitocin 2ml, Exenel 1ml/10 kg weight for 5 consecutive days, and Estrumate (PG F2 alpha) of 2ml / m. The effectiveness of therapeutic scheme resulted 60% in the first group and gave 3 recidives. The effectiveness of therapeutic scheme in the second group resulted at 90% and gave 1 recidive. This result shows the effects of prostoglandin in involucionin uterin, evacuation of products inflamative, stimulate the next cycle, stimulating the local immune uterin and uterine contraction improved. Therefore, more efficient protocols for the treatment of endometritis and metritis of cow's milk are combinations of antibiotic therapy with the hormonal, which improve parameters of reproduction and improving of the fertility.

Key words: cow's milk, metritis, PgF2alfa, Exenel

HYRJE

Shëndeti uterin, pas pjelljes së lopëve, është një nga problemet më të zakonshme, i trajtuar gjerësisht nga autorë të ndryshëm (10). Risku i faktorëve për infeksionin uterin është i lartë, por programet për parandalimin e kësaj patologjie ende nuk janë nga më efikasat. Ende nuk është përcaktuar regjimi më i mirë terapeutik. Ende diskutohet për trajtimin ose mostrajtimin vetëm me antibiotik të rasteve me endometrite klinike. Dilemat përfshijnë efektivitetin ekonomik të trajtimit, duke u nisur nga kapaciteti

prodhues dhe rreziqet nga mbetjet e antibiotikëve në qumësht apo mish. (5).Lopët që janë sistematikisht të sëmurë nga infeksionet uterine (metriti akut) kërkojnë një vëmendje të veçantë.

Mukoza uterine pas pjelljes është në kontakt të vazhdueshëm me lëngjet dhe indet që favorizojnë rritjen bakteriale. Kontaminimi bakterial shfaqet në 90% të lopëve të qumështit gjatë javës së parë pas pjelljes. (10). Ecuria e kontaminimit uterin është në varësi të numrit dhe virulencës së organizmave të pranishme, aq më tepër nga gjendja e uterusit dhe mekanizmat mbrojtëse të trashëguara gjenetiksht. Një numër i ndryshëm bakteriesh izolohen prej uterusit në periudhën e hershme pas pjelljes. Shumë prej tyre e kanë origjinën nga kontaminimet mjedisore dhe eliminohen gradualisht gjatë 6 javëve të para pas pjelljes.

Lopët me probleme para pjelljes e kanë të reduktuar aftësinë për kontrollin e infeksionit uterin. Lopët me lindje të vështirë ose me sëmundje metabolike e kanë të kufizuar aftësinë kontraktuese të uterusit, duke vonuar kohën e involucionit uterin. Kjo gjendje çon në mbajtjen e lëngjeve dhe mbetjeve të cipave fetale

përtej periudhës normale, duke krijuar një mjedis tepër të përshtatshëm për zhvillimin e bakterieve patogjene. Problemet në lindje apo mbajtja e placentës reduktojnë aftësinë uterine për angazhimin e antitropave për shkatërrimin e bakterieve patogjene. Zgjatja e infertilitetit shoqërohet me infeksion uterin, etj. (8).

MATERIALI DHE METODA

Studimi u krye te lopët e fermës “Derveni” për një periudhë 1-vjeçare (2008). Krerët e marra në studim u monitoruan për infeksione vaginale dhe uterine, dy javë para pjelljes deri gjashtë javë pas pjelljes. Shenjat klinike të metriteve, në shkallë të ndryshme zhvillimi, u përcaktuan në 20 krerë lopë të racës Holshtein, me laktacion të ndryshëm. Përcaktimi i diagnozës u bazua në tipin e rrjedhjeve klinike dhe praninë ose jo të erës në rrjedhjet vaginale (Sheldon; Dobson 2004).

Krerët që u vlerësuan me 3 pikë për të dy vlerësimet u përfshinë dhe në termometrimin rektal si dhe në 3 kontrole rektale për ecurinë e involucionit uterin (i pari para trajtimit, i dyti pas trajtimit dhe i treti dy javë pas trajtimit).

Përshkrimi	Pikë
Karakterit i mukosit	0
Mukus i qartë ose transkulent.	1
Mukus i qartë ose transkulent me fijeza ose qelb i bardhë.	2
< 50 ml përmbajtje exudati < 50% qelb i bardhë ose kremoz.	3
>50 ml përmbajtje exudati > 50% qelb i bardhë, kremoz dhe rrema gjaku.	0
Era e mukosit	3
Mukus pa erë.	
Mukus me erë të keqe.	

Tab. 1. Skema e vlerësimit klinik të endometriteve.

Grupet	Nr. krerëve	Exenel	Oxitocin	Estrumate	Krerë të shëruar	% e shërimit	Recidiva %
Gr. I	10	+	-	-	6	60	30
Gr. II	10	+	+	+	9	90	10

Shënim: me shenjën (-) krerë të patrajtuara, me shenjën (+) krerë të trajtuara

Tab. 2. Rezultatet e mara për të dy skemat e mjekimit.

Rezultuan me endometrite dhe metrite 20 krerë, që përfaqësonin 13,8 % të totalit të kafshëve të kontrolluara. Këto lopë u ndanë në dy grupe. Qellimi i

këtij studimi është krahasimi i dy skemave të mjekimit të metriteve për të konkluduar mbi efikasitetin e skemës më të përshtatshme.

Skema e parë e mjekimit

Grupi i parë i lopëve me metrite (10 krerë) iu nënshtrua skemës së mjekimit vetëm me antibiotik, konkretisht me Exenel (Exenel flacon 100 ml, Crawley, RH 102LZ,UK) me dozë 1 ml/10 kg peshë të gjallë i/m për 5 ditë rresht.

Skema e dytë e mjekimit

Grypi i dytë i lopëve me metrite (10 krerë) iu nënshtrua skemës së mjekimit të kombinuar. Në këtë skemë u përfshinë: aplikimi i antibiotikut Exenel 1ml/10kg peshë të gjallë i/m për 5 ditë rresht, Oxitocinë 2ml/krerë i/m si dhe Estrumate (Pg F2-alfa) 2ml/krerë i/m.

Trajtimet në të dy grupet u kryen me rigorozitet si në lidhje me respektimin e dozës, intervalit dhe kohëzgjatjes për gjithë krerët duke mbajtur regjistrin e


të dhënave për çdo ditë të trajtimit dhe ecurisë së gjetjeve klinike.

REZULTATET DHE DISKUTIME

Rezultatet e marra treguan diferenca të dukshme midis dy skemave të zbatuara. Krerët e trajtuara me skemën e parë patën një shkallë shërimi më të ulët deri në 60%, shkallë të ulët të involucionit uterin, si dhe praninë e tre recidivave.

Krerët e trajtuar me skemën e dytë, që përveç antibiotikut përfshinte dhe aplikimin e Oxitocinës dhe Prostaglandinës F2-alfa (Estrumate) patën një shkallë të lartë të shërimit, deri 90 % dhe vetëm një recidivë.

Këto rezultate të marra tregojnë për efektshmërinë farmako-klinike të kombinimit të antibiotiko-terapisë me terapinë hormonale.



Grafiku 1. Efektiviteti i skemave të mjekimit.

Sic shihet dhe nga grafiku, në grupin e dytë numri i krereve të shëruar (të trajtuar me skemën e kombinuar (antibiotik + prostoglandinë + oksitocinë) është më i madh, ndërsa recidivat kanë rënie të ndjeshme. Në rastin e skemës së parë, antibiotiku (Exenel) arrin të japë një efikasitet të ulët. Në këtë situatë produktet inflamative dhe fluidet ngelen në kavitet duke dhënë premisa për recidiva në përqindje të lartë, deri 60%. Në rastin e aplikimit të skemës së dytë, prania e oksitocinës siguron stimulimin e tkurrshmërisë uterine dhe nxjerrjen e produkteve inflamative dhe florës patogjene me rrjedhjet vaginale. Me interes mbetet të përmendet fakti që prania në këtë skemë e

prostoglandinës plus oksitocinën siguron një gjendje më të mirë të uterusit, një involucion më të hershëm uterin si dhe një stimulim të imunitetit lokal. Këto efekte sigurojnë një shkallë të lartë shërimi, si dhe nivel shumë të ulët të recidivave. Efektshmëria e aplikimit të skemës së dytë në lopët me metrite përfshin efektet potencuese të kombinimit të antibiotikoterapisë me hormonoterapinë.

Prostaglandina ofron një reagim shumë të shpejtë mbi qelizat epiteliiale të endometriut nëpërmjet stimulimit direkt të mekanizmave të imunitetit lokal. Rritja e efikasitetit të mekanizmave imunitare lokale shoqërohet me një largim të dyfishtë të florës

patogene dhe për rrjedhojë dhe të endotoksinave të prodhuara prej tyre. Rënia e nivelit të endotoksinave shoqërohet me shërimin e metriteve dhe involucion te plotë uterin. Ky efekt i prostaglandinës mbi metritet është pasqyruar dhe në studimin tonë ku në protokollin e aplikimit të prostaglandinës kemi shkallë të lartë të involucionit uterin, ulje të ndieshme të recidivave, si dhe përmirësim të dukshëm të parametrave të riprodhimit. Përmendim se dhe gjatë ndjekjes së ecurisë së parametrave të riprodhimit për krerët e marra në studim rezultuan me diferenca të dukshme për krerët e trajtuara me prostaglandine. Në përfundim të këtij reflektimi theksojmë se mekanizmat e fuqishme të efekteve të prostaglandinës mbi mjekimin e metriteve megjithëse ende nuk janë plotsisht të studjuara mirë bazë mbetet: evakuimi i masës inflamative, ulja e nivelit të endotoksinave, stimulimi i imunitetit lokal dhe rigjenerimi i endometriumi.

PËRFUNDIME

1. Në lopët e qumështit kontaminimi pas pjelljes i kavitetit uterin është i pashmangshëm dhe prania e bakterive patogjene zakonisht shkakton sëmundje klinike të vaginiteve, endometriteve, metriteve, si dhe patologji të vezoreve.
2. Këto patologji shoqërohen me uljen e fertilitetit, me vonesë të involucionit uterin dhe kohës së ovulimit të parë pas pjelljes. Këto patologji japin dhe prani të trupit të verdhë dhe ulje të ritmit të barsmërisë me ndërzimin e parë.
3. Të gjithë këta faktorë kërkojnë vendosjen e një diagnoze sa më efektive dhe trajtimin në kohë dhe me skema sa më efikase duke zbatuar programin e kontrollit dhe të menaxhimit të sëmundjeve të riprodhimit.
4. Stimulimi i ambientit endokrin jep një stimulim dhe të përgjigjes imune duke treguar ndërveprimin e sistemit imun me atë endokrin si mekanizmat bazë për të mbajtur një uterus të shëndetshëm dhe funksional. Aplikimi i prostoglandinës plus oksitocinën realizon një stimulim të sistemit imun dhe atij endokrin.

LITERATURA

1. Barlett P. C.; Kirk J. H.; Wilke M. A. (1986). Metritis complex in Michigan Holstein-Frieian cattle: incidence, descriptive epidemiology and estimated economic impact. *Prev Vet Med.* 4: 235-248.
2. Beede D. K.; Risco C. A.; Donovan G. A.; Wang C.; Archbald L. F. (1991). Nutritional management of the late pregnant dry cows with particular reference to dietary cation-anion difference and calcium supplementation. *Convention Proceedings AABP, Orlando, FL,* , pages 51-55.
3. Goff J. P.; Horst R. L. (1993). Oral administration of calcium salts for treatment of hypocalcemia in cattle. *J. Dairy Sci.* 76:101.
4. Goff J. P.; Horst R. L. (1994). Calcium salts for treating hypocalcemia: carrier effects, acid base balance, and oral versus rectal administration. *J Dairy Sci:* 77:1451.
5. Kristula M.; Smith B. I.; Simeone A. (2001). The use of daily postpartum rectal temperature to select dairy cows for the treatment with systemic antibiotics. *The Bovine Practitioner* 35:2, pages 117-125.
6. Massey C. D.; Wang C.; Donnvan G. A. (1993). Hypocalcemia at parturition as risk factor for left displacement of the abomasums in dairy cows. *J Am Vet Med Assoc* 1993;203:852.
7. Queen W. G.; Miller G. Y.; Masterson M. A. (1993). Effects of oral administration of a calcium-containing gel on serum calcium concentration in postpartum dairy cows. *J M Vet Med Assoc;* 202:607-609.
8. Risco C. A.; Drost M.; Thatcher W. W. (1994). Effects of retained fetal membranes, milk fever, uterine prolapse or pyometra on postpartum uterine and ovarian activity in dairy cows. *Therigenology* 42: 183.
9. Risco C. A.; Moreira F.; DeLorenzp M.; Thatcher W. W. (1998). Timed artificial insemination in dairy cattle- Part II. *Compendium in Continuing Education* 20(11): 1284-1289.
10. Sheldon I.; M.; Dobson H. (2004). Postpartum uterine health in cattle. *Animal Reproductive Science:* 82-83, 295-306.
11. Sheldon, I.; M.; Noakes.; D.E. Rycroft.; Dobson, H.; 2002 a. Effect of postpartum manual examination of the vagin on uterine bacteril contamination in cows. *Veterinary Record* 151, 531-534.